MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT, QARKU ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Qarku Elbasan, me objekt "Mbi veprimtarinë për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit" për periudhën 01.07.2010 deri 31.12.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 130 datë 15.09.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 731/8 datë 15.09.2012, dërguar Z. [redacted], Kryetar i Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Elbasan, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. ARM të kërkojë nga MMPAU hartimin e procedurave të qarta për mënyrën e studimit të dokumentacionit, të këqyrjes së vendit në terren, mënyrën e vendimmarrjes për autorizimin dhe pëlqimin mjedisor si dhe hartimin e mendimit për veprimtarinë e propozuar, trajtuar në faqet 7 - 17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

2. ARM, të kompletojë regjistrin e lejeve mjedisore me të gjitha të dhënat të cilat përcaktohen në nenin 45/1, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, trajtuar në faqet 7 - 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

3. ARM në pajisjet me autorizim dhe pëlqim mjedisor të specifikojë me hollësi sipas tipit të projektit kushtet e ndërtimit dhe funksionimit të veprimtarisë së lejuar, mënyrën e administrimit mjedisor të mbetjeve si dhe të atyre të rrezikshme, duke përcaktuar konkretisht sasinë dhe volumin që gjenerohen, grumbullimin dhe trajtimin e tyre si dhe të specifikojë vendin e depozitimit përfundimtar, të caktuar nga pushteti vendor, trajtuar në faqet 12 – 17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

4. ARM në pëlqimin dhe autorizimin mjedisor të përcaktojë në mënyrë të hollësishme masat që do të marrë subjekti për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe zhvillimit, duke përcaktuar konkretisht sipërfaqen e gjelbërt, llojin e bimësisë, mënyrën e trajtimit mjedisor të mbetjeve si dhe specifikimet e tjera sipas natyrës dhe veçantive të projektit, trajtuar në faqet 12 – 17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

5. ARM, të përcaktojë në mënyrë të detajuar monitorimin e shkarkimeve, ku të pasqyrohen të gjitha llojet dhe tipet e shkarkimeve, të shkaktuara nga veprimtaria gjatë fazës së ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim të shprehura në sasi dhe volum si dhe të vendosë normat e shkarkimeve të lejuara sipas veçantive të projektit, trajtuar në faqet 7 – 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

6. ARM, të përcaktojë masat parandaluese dhe rehabilituese për mjedisin që do të ndotet dhe dëmtohet gjatë fazës së ndërtimit dhe zhvillimit sipas tipit të veprimtarisë duke vendosur masa dhe afate konkrete për rehabilitimin e mjedisit të ndotur apo dëmtuar, trajtuar në faqet 7 – 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

7. ARM, në mendimet e dhëna për lejet mjedisore, bazuar në raportin teknik dhe në raportin e VNM, të pasqyrojë në mënyrë konkrete sasinë e çlirimeve dhe daljes në mjedis të lëndëve të gazta, të ngurta e të lëngëta të vibracioneve e zhurmave për çdo subjekt sipas natyrës së aktivitetit që do të aplikojë, trajtuar në faqet 7 – 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

8. ARM, në mendimet e dhëna për lejet mjedisore, të shprehet nëse projekti i propozuar është në përputhje me legjislacionin në përgjithësi dhe atë mjedisor në veçanti, trajtuar në faqet 7 – 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

9. ARM, të bëjë pjesë të dokumentacionit të dosjes, shtojcat e plotësuara të udhëzimit nr. 3, datë 19.11.2009, "Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis", trajtuar në faqet 7 – 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

10. ARM të informojë në mënyrë periodike dhe të detyrojë subjektet që të dorëzojnë rregullisht raportet e vetëmonitorimit pranë saj, ku në to të pasqyrohen analizat specifike të kryera sipas të gjitha kushteve të vendosura në lejet përkatëse mjedisore, trajtuar në faqet 17 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

11. ARM në zbatim të nenit 82 "Sanksionet", pika 2/ç, ligji nr, 8934, datë 05.09.2002, i ndryshuar të gjobisë subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarkun e Elbasanit, duke qenë të pajisura me leje mjedisore, për mos dërgimin e të dhënave për gjendjen e mjedisit në afatet e përcaktuara, trajtuar në faqet 17 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

12. ARM të hartojë raportin vjetor mjedisor për qarkun e Elbasanit në bazë të të dhënave mbi gjendjen e treguesve të mjedisit të grumbulluara nga subjektet të cilat kryejnë vetëmonitorime të shkarkimeve të veprimtarisë së tyre në mjedis, trajtuar në faqet 17 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

13. Njësia e Inspektimit pranë ARM Qarku Elbasan të hartojë objektiva e plane të hollësishme me parametra të përcaktuar, për kryerjen e inspektimeve të vazhdueshme e të përsëritshme mbi gjendjen e të gjithë treguesve mjedisorë si dhe mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në qarkun e Elbasanit, trajtuar në faqet 22 – 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

14. Njësia e Inspektimit pranë ARM-së në zbatim të nenit 83, pika 1/b, ligji nr. 8934, datë 05.09.2002, i ndryshuar të gjobisë ato subjekte të cilat ushtrojnë aktivitet në qarkun e Elbasanit dhe rezultojnë të pa pajisura me dokumentacion mjedisor, trajtuar në faqet 22 – 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

15. Njësia e Inspektimit pranë ARM-së në akt kontrollet apo akt verifikimet e mbajtura gjatë inspektimeve të kryera, të lërë detyra specifike bazuar në aktivitetin e problematikën e subjektit si dhe të mbështetura në kushtet e lejes mjedisore e në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, trajtuar në faqet 22 – 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

16. Njësia e Inspektimit pranë ARM-së të hartojë regjistrin e të dhënave për të gjitha subjektet e kontrolluara të shoqëruara me detyrat përkatëse si dhe regjistrin ku të jenë të evidentuara subjektet me ndikim të lartë e të mesëm në mjedis, trajtuar në faqet 22 – 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

17. ARM të hartojë programe të përbashkëta bashkëpunimi dhe kontrolli me të gjithë subjektet që ligji ngarkon në mbrojtje të mjedisit, si dhe të kërkojë me rigorozitet zbatimin e tyre, trajtuar në faqet 32 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

18. Për të shkallëzuar sanksionet administrative, nga ARM të bëhet klasifikimi i shkeljeve sipas referencave ligjore si dhe verifikimet në subjektet e gjobitura për arkëtimin e gjobave të vëna, trajtuar në faqet 36 – 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

19. Inspektorët e mjedisit në Njësinë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan, në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit të udhëhiqen nga rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes, trajtuar në faqet 36 – 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

B. <u>MASA DISIPLINORE</u>

1. Mbështetur në nenin 37, 141, 153 e 154 të ligjit 7961 datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe në kontratën kolektive të punës do t'i kërkohet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

<u>"Largim nga detyra"</u>

Për:
1. Z. [redacted], me detyrë Koordinator i Njësisë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan;

- Për organizim jo të mirë të planit të punës të Njësisë Inspektuese, gjë që pasqyrohet në shpërndarje jo të mirë të numrit të inspektorëve gjatë inspektimeve, në mos planifikimin e rikontrolleve në subjekte për të cilat janë lënë detyra gjatë inspektimeve të mëparshme dhe në subjekte që kanë rezultuar pa dokumentacion mjedisor, etj.
- Për mos njohje të inspektorëve të mjedisit të Njësisë Inspektuese me dosjen mjedisore të subjektit i cili do të kontrollohet, pasi në shumë raste inspektorët i janë kthyer kontrollit të të njëjtit subjekt i cili disa herë ka rezultuar pa dokument mjedisor dhe nuk është gjobitur në kundërshtim me nenin 83, pika 1/b, ligji nr. 8934, datë 05.09.2002, i ndryshuar me ligjin nr. 9983, datë 08.09.2008.
- Për mos hartimin e planeve mujore apo vjetore për monitorimin e mjedisit në mënyrë periodike, të miratuara më parë nga organet përkatëse në Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
- Për mos shpërndarje të rregullt të inspektimeve pasi pjesa më e madhe e tyre janë kryer në subjekte të pa pajisura me dokumentacion mjedisor duke lënë pas dore subjektet e pajisura me dokumentacion mjedisor për të cilat duhen lënë detyra me qëllim përmirësimin e situatës mjedisore.
- Njësia Inspektuese nuk ka detyruar dhe ndihmuar subjektet që janë pajisur me leje mjedisore e që ushtrojnë aktivitet në qarkun e Elbasanit, nëpërmjet shkresave zyrtare periodike, për kryerjen e rregullt të vetëmonitorimeve nga ana e tyre, sidomos për subjektet që me aktivitetin e tyre kanë ndikim të lartë në mjedis, veprim i cili është në kundërshtim me pikën ç/1 të nenit 71, ligji nr. 8934, datë 05.09.2002, i ndryshuar.
- Për mangësitë e renditura si më poshtë për inspektorët e mjedisit duke qenë se z. Milloshi ka marrë pjesë si inspektor në pjesën më të madhe të inspektimeve të kryera.

2. Mbështetur në nenin 37, të ligjit 7961 datë 12.07.1995, i ndryshuar, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", dhe në kontratën kolektive të punës Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje me paralajmërim"

Për:
1. Z. [redacted] me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan;
2. Z. [redacted] , me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan;
3. Z. [redacted], me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan;
4. Z. [redacted], me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan;
5. Z. [redacted], me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan;
6. Z. [redacted], me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan;

7. Z. [redacted], me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese, pranë ARM Qarku Elbasan;

- Për mos aplikim të gjobës për subjektet të cilat duke qenë të pajisura me leje mjedisore nuk kanë dërguar në afat të dhënat për gjendjen e mjedisit, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 82 pika 2/ç e 2/d si dhe me nenin 83 pika 1/c, ligji nr. 8934, datë 05.09.2002, i ndryshuar me ligjin nr. 9983, datë 08.09.2008.
- Për papërgjegjshmëri dhe nivel të ulët profesionalizmi në plotësimin e aktkontrolleve dhe aktverifikimeve të cilat rezultojnë me gabime si dhe në lënien e detyrave të cilat nuk janë të bazuara në lejen mjedisore përkatëse dhe në ligj.
- Për mosndjekje në vazhdimësi dhe mos kryerjen e kontrolleve periodike në subjekte që rezultojnë pa dokumentacion mjedisor gjë që bën të pamundur të vërtetohet nëse subjekti është pajisur me të si dhe mos kryerjen e rikontrollit të detyrave të lëna gjatë inspektimeve të mëparshme.
- Për trajtimin jo njëlloj të subjekteve, për të cilët koha e lënë në dispozicion për tu pajisur me dokumentacion mjedisor nuk është e njëjtë në të gjitha rastet.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Mimoza Lloji, Agron Maksutaj**,** Keida Muça**,** Ermira Vojka, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Erjon Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT